



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 915/<sub>2</sub> prot.

Tiranë, më 20.12.2023

**VENDIM**

Nr. 50, datë 20.12.2023

**“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT DHE PROGRAMIT  
PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT TË FORMIMIT FILLESTAR  
PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në mbështetje të nenit 248 dhe 263 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenit 60 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe të nenit 45/1 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planin dhe Programin Mësimor për Formimin Fillestar për subjektin e rivlerësimit për znj. F. Ç , për vitin akademik 2023-2024, sipas materialit bashkangjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi të përcillet pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 915/3 prot.

Tiranë, më 20.12.2023

**V E N D I M**

Nr. 51, datë 20.12.2023

**“PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PEZULLIM TË SË DREJTËS PËR NDJEKJEN E  
PROGRAMIT FORMIMIT FILLESTAR PËR KANDIDATEN PËR MAGJISTRATE  
A T PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Bazuar në nenin 19, pika 6, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” si dhe Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e znj. A T candidate për magjistratë, profili prokuror, për pezullim të së drejtës për ndjekje të Programit të Formimit Fillestar në vitin akademik 2023-2024 deri në fillim të vitit akademik 2024-2025.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

